

I ORTAKVE TE SHOQERISE TREGTARE
"A V E L" SH.P.K .TIRANE

Ne Tirane , sot ne daten 24, muajit Korrik , viti 2017 u zhvillua Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "A V E L" SH.P.K. Tirane , ne seline e saj , me rend dite :

1. Ecuria e deritanishme mbi realizimin e treguesve financiar te shoqerise si dhe ridiskutimi per destinacionit te fitimit neto te vitit ushtrimit 2016.
2. Emerimi i Ekspertit Kontabel i Regjistruar per procedurat e zmadhimit te kapitalit themeltar.

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise Tregtare "A V E L" SH.P.K. Tirane , e perbere nga z.Avni Ponari dhe z.Adrian Totokoci pasi u njoh me rendin e dites ;

VEREJTEN SE

Gjate shqyrtimit te treguesve financiare te shoqerise tregtare "A V E L" SH.P.K . Tirane , Ortaket , konstatuane se shoqeria ka arritur rezultate te kenaqeshme. Per nje ecuri me te mire te shoqerise ne te ardhmen , per te patur nje vazhdimesi , qendrueshme , dhe siguri te veprimtarise , si dhe per te rritur besushmerin e saj ndaj institucioneve bankare dhe partnereve , te behet zmadhimi i Kapitalit te Regjistruar te kesaj shoqerise , ne baze te Statutit dhe Aktit te Themelimit te saj ; si dhe ne baze te Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe shoqerite tregtare", Ligji Nr. 8438 date 28.12.1998 ndryshuar me ligjin Nr.9326 date 6.12.2004 "Per tatimin mbi te ardhurat ",me fitimin e realizuar gjate vitit 2016.

Per keto arsye , Ortaket ;

VENDOSEN :

- 1 - Zmadhimi i Kapitalit te Regjistruar te shoqerise "A V E L"SH.P.K . Tirane , me fitimin e vitit 2016 .
- 2 - Te caktoje z. Teki Flamuri, anetar i dhomes se IEKA , me profesionin Ekspert Kontabel i Regjistruar me Nr. license 106 date 10.01.2001, per kontrollin e fitimit te realizuar gjate vitit 2016 me te cilin do te zmadhohet Kapitalit te Regjistruar si dhe vleresimin e kuotave qe zoterojne ortaket e shoqerise .
- 3 - Depozitimi i ketij vendimi pranë Qenders Kombetare te Biznesit TIRANË

ASAMBLEJA E SHOQËRISË TREGTARE "A V E L" SH.P.K .

O R T A K E T

(Adrian TOTOKOCI) (Avni PONARI)



**I ASAMBLESË SË TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË TREGTARE "A V E L" SH.P.K .**

Në Tiranë , sot në datën 28 Korrik 2017 , u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare "A V E L" SH.P.K. , në selinë e saj , me rend dite :

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar , të datës 27.07.2017 , përgatitur nga z. Teki FLAMURI , për kryerjen e procedurave për të realizuar zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar i Shoqërisë;

Asambleja e Ortakëve e përbërë nga z.Avni Ponari dhe z.Adrian Totokoci pasi u njoh me rendin e ditës ;

VËREJTEN SE :

Ortakët e kesaj shoqërie janë z.Avni Ponari z.Adrian Totokoci. Kapitalit të Regjistruar i kësaj shoqërie aktualisht është 310 000 000 leke . Ky kapital është i ndarë në këtë mënyrë:

1. **Z. Avni Ponari**, zotëron 80 % të kapitalit themeltar, e barabartë kjo me 248 000 000 leke
2. **Z. Adrian Totokoci**, zotëron 20 % të kapitalit themeltar, e barabartë kjo me 62 000 000 leke

Me Vendimin Nr. 19 datë 24.07.2017 , Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ka proceduar konform dispozitave ligjore për shtesën e Kapitalit të Regjistruar; duke caktuar z. TEKI FLAMURI Ekspert Kontabël i Regjistruar, me Liçensë Nr.106 datë 10.01.2001, për kontrollin e fitimit të ushtrimit 2016 i cili do të përdoret për zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar.

Në vështrim të rendit të ditës , Asambleja e Ortakëve të kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar , të datës 27.07.2017 , i përgatitur nga z. TEKI FLAMURI , për Vlerësimin e Fitimit të realizuar gjatë ushtrimit 2016 me të cilin do të bëhet zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë , vëren se ky raport është i drejtë , në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar nga Asambleja e Ortakëve .

Sipas këtij raporti, Kapitalit të Regjistruar i shoqërisë do të zmadhohet në shumën 30 000 000 leke me fitimin e ushtrimit 2016 . Pas zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar ai bëhet nga 310 000 000 leke në 340 000 000 leke.

Mbeshtetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008 neni 68 i ndryshuar me ligjin 129/2014 secili nga dy ortakët e shoqërisë zotërojnë nga një kuota . Kapitali i Regjistruar vlefshëm nominal dhe përqindja e zotërimit të kapitalit prej ortakëve do të jete si më poshtë :

1. **z. Avni Ponari** nga 1 kuota me vlefte 248 000 000 leke që zotëronte para zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë , do të zotërojë një kuotë , vlefte e të ciles pas zmadhimit të kapitalit është 272 000 000 lek edhe përfaqëson 80 % të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "A V E L" sh.p.k..
2. **z. Adrian Totokoci** nga 1 kuota me vlefte 62 000 000 leke që zotëronte para zmadhimit të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë , do të zotërojë një kuotë , vlefte e të ciles pas zmadhimit të kapitalit është 68 000 000 lek edhe përfaqëson 20 % të Kapitalit të Regjistruar të shoqërisë "A V E L" sh.p.k..

Për këto arsye, Asambleja e Ortakëve , me votim unanim;

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabel të Regjistruar të datës 27.07.2017 , përgatitur nga z. Teki Flamuri , për zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
2. Zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar të kësaj shoqërie në shumën **30 000 000 leke** .

3. Pas ketij zmadhimi Kapitali i Regjistruar i kësaj shoqërie behet 340 000 000 leke dhe eshte i ndare si me poshte;

*** Z. Avni Ponari, zotëron 80 % të Kapitalit te Regjistruar, ose nje kuote e barabartë me 272 000 000 leke**

*** Z. Adrian Totokoci, zotëron 20% të Kapitalit te Regjistruar, ose nje kuote e barabartë me 68 000 000 leke**

4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare te Biznesit TIRANË.

PER ASAMBLENE E SHOQËRISË TREGTARE

"A V E L" SH.P.K.

ORTAKET

(Adrian TOTOKOCI)

(Avni PONARI)

